E mërkurë, 4 prill 2024

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

[I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Sot do të vijojmë me dëshminë e dëshmitarit W04739.

Vërej për procesverbal që z. Krasniqi na ndjek përmes videolidhjes, ndërsa tre të akuzuarit e tjerë janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

Sidoqoftë, janë disa aspekte që duhen trajtuar paraprakisht ndërkohë që jemi në seancë publike.

Trupi Gjykues është disi i shqetësuar sa i takon mungesës së katër të akuzuarve herë pas here në sallën e gjyqit kur kemi gjykim. Ne besojmë se të akuzuarit si rregull duhet të jenë fizikisht të pranishëm në sallën e gjyqit kur paraqiten prova, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme kur mund t’i ndjekin përmes lidhjes, përmes videolidhjes. Kur marrin

leje për të mos qenë të pranishëm, nuk ka ndonjëherë arsyetim pse nuk janë të pranishëm.

Ne mbështetemi në rregullën 68(1) ku thuhet se:

"Të akuzuarit duhet të jenë të pranishëm në sallën e gjyqit me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji dhe nga Rregullorja."

Sigurisht, që Trupi Gjykues mendon që të akuzuarit ndonjëherë mund të mos jenë të pranishëm nëse lind nevoja dhe këtë mund ta bëjnë përmes Avokatit të tyre.

Rregulla 168 [Sipas përkthimit], pika 4 thotë "Kur të akuzuarit nuk duan të paraqiten, Trupi Gjykues mund të urdhërojë që gjykimi të bëhet pa praninë e akuzuarve, por duhet të plotësohen disa kushte për këtë.

Kërkesat që ne marrim këtu nuk janë më shumë refuzime, por më shumë parapëlqime të të akuzuarve ta ndjekin gjykimin përmes videolidhjes. Sigurisht kur ka arsye të vlefshme, kjo lejohet, dhe ne e kuptojmë që prania e të akuzuarve mund të mos jetë e nevojshme kur edhe dëshmitari është përmes videolidhjes, apo kur në sallën e gjyqit do të diskutohen aspekte që nuk lidhen drejtpërdrejt me dëshmitarët.

Ka ndonjë koment prej palëve në lidhje me këtë aspekt?

Urdhërojmë pra, që të gjitha kërkesat për të mos marrë pjesë në sallën e gjyqit gjatë gjykimeve të kenë një arsyetim të kënaqshëm pse të akuzuarit nuk do të jenë të pranishëm, pra të kenë arsye të vlefshme, leje të tilla i duhen paraqitur

Trupit Gjykues brenda 24 orësh para gjykimit, përndryshe nuk do të lejohen të tilla situata më.

Dhe me kaq mbyll urdhrin me gojë të Trupit Gjykues.

Gjithashtu, duam të trajtojmë dhe një aspekt tjetër sa i takon listës së prezantimeve të palëve.

Vërejmë që janë shtuar shumë materiale me vonesë në listën e prezantimeve të palëve, edhe nuk janë paraqitur pothuajse fare arsyet për këto vonesa në shtimet e materialeve.

Trupi Gjykues dëshiron të theksojë që në përputhje me afatet që gjenden në urdhrin për zhvillimin e gjykimit, duhen dorëzuar në kohë. Dhe kur shtohen me vonesë materialet, pala do të japë edhe arsyet pse është shtuar me kaq vonesë një material dhe pse nuk është shtuar më përpara.

Atëherë, Trupi Gjykues thekson që duhet të përpiqen më shumë palët që kur dorëzojnë dokumentet, lista të jetë në formën e vet përfundimtare.

Me kaq mbyll dhe urdhrin e dytë me gojë.

Tani mund të vijojmë me dëshminë e dëshmitarit të ditës së sotme, me numër 04739.

Ju lutem ndërkohë, Sekretare e Gjykatës, na kaloni në seancë të mbyllur.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Bëjmë dhjetë minuta pushim, rikthehemi këtu në orën 10.15.

--- Pauza fillon në orën 10.04

--- Seanca rifillon në orën 10.15

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë të mbyllur.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta ndërpresim seancën deri në momentin që të katër të akuzuarit të jenë të pranishëm. Në rregull.

--- Seanca ndërpritet në orën 10.19

--- Seanca rifillon në orën 10.43

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shoh që z. Krasniqi jeni kthyer. Uroj të ndjeheni më mirë.

Do të vazhdojmë deri në orën 11.30, bëjmë gjysmë ore pushim pastaj 12.00 me 1.00 bëjmë pushimin e drekës si

zakonisht dhe i rikthehemi seancave të zakonshme.

Kalojmë në seancë të mbyllur.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Marrim pushim deri në orën 12.00.

--- Seanca ndërpritet në orën 11.35

--- Seanca rifillon në orën 12.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetjet e Gjykatësit Mettraux tani. Po mbase duhet të sjellim një herë dëshmitarin.

Në rregull, atëherë, kalojmë në seancë të mbyllur dhe sjellim dëshmitarin.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

PUBLIC

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pauzë deri në orën 2 e gjysëm.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

--- Seanca rifillon në orën 9.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në seancë të mbyllur.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

Z. EMMERSON: [Përkthim] Kam një aspekt tjetër. Sa i takon -- presim pak. Ju kërkojmë ndjesë.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, jemi në seancë publike.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Sa i takon pyetjeve që dolën nga anëtarët e Trupit Gjykues, ky është rasti i parë kur Mbrojtja kërkon një shkëputje në mënyrë që të përgatitet siç duhet.

Siç ju thashë në seancë private, unë mund t'i bëj një a dy pyetje tani bazuar në pyetjet e Gjykatësve para pushimit të drekës, por më vjen keq më duhet t'ju them që shumica e pyetjeve nga anëtarët e Trupit Gjykues kërkojnë shumë kohë prej nesh.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ne s'do ta çojmë dëm ne gjysëm oraréshin. Na ka ngelur dhe një orë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë po ju them që nuk mund t'i bëj pyetjet, s'e kuptoj çfarë ka kaq të vështirë këtu.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pikë së pari pyetjet e Gjykatësit Barthe nuk kërkojnë shqyrtim të ndonjë dokumenti.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, pra, mund ta trajtoj një aspekt që buron nga Gjykatësi Barthe.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe tani po pyes Ekipet e tjera të Mbrojtjes a janë gati ndonjë prej Ekipeve të tjera të Mbrojtjes të bëjnë kundërpyetjet dhe më pas t'i bëni ju kundërpyetjet më vonë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po tani kjo është një çështje që ta vendosin anëtarët e tjerë të ekipeve të Mbrojtjes.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] U drejtohem ekipeve të tjera a është ndonjë prej ekipeve gati të bëjë një orë pyetje tani, një orë që na ka mbetur?

Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, nuk jam gati në këto momente. Unë jam në situatë të ngjashme. Jo aq shumë sa z. Emmerson, po jam në situatë të ngjashme.

Edhe s'i ka bërë pyetjet as Gjykatësi Gaynor, ta pyesim Gjykatësin Gaynor.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje unë.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo. Dhe unë jam në të njëjtën situatë. Kam nevojë të përgatitem.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mbështes parashtrimin e z. Emmerson. Duhet të përgatitemi tani se kanë dalë shumë aspekte që lidhen me klientin tonë.

Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk dua ta marr përsipër diçka kot. Sepse unë për momentin nuk kam pyetje, unë si rregull do të isha personi i katërt po për momentin nuk kam pyetje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. E bëjmë atë pushimin dhjetë minutësh. Dhe kur të kthehemi do ju japim vendimin.

--- Seanca ndërpritet në orën 15.34

--- Seanca rifillon në orën 15.45

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Së pari po pyes z. Halling a ka ndonjë pyetje?

Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje. Kishte disa materiale që i përdorën Gjykatësit dhe ne donim që këto të pranoheshin nga lista jonë e provave materiale. Por duke marrë parasysh që mund të ketë kundërshtime për këtë, do të bëjmë parashtrim me shkrim pasi të përfundojë dëshmitari.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë kundërshtim ta përfundonim tani, ta linim pra orën e fundit.

Z. HALLING: [Përkthim] Në fakt ne do të kishim dashur të përfundonim me këtë dëshmitar këtë javë, por në këto kushte e mbështesim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mesa duket nga Mbrojtjes është e pamundur.

Jemi pak të zhgënjyer në fakt.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo thjesht nuk thashë gjë. Po pres gati në këmbë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi pak të zhgënjyer. Asnjë nga dokumentet që u përdorën nuk janë dokumente të reja. Të gjitha janë pjesë e dokumentacionit gjyqësor. Pyetjet ishin në linjë me diskutimet që ishin bërë më herët, dhe kam shumë të vështirë të them të drejtën të çoj dëm një orë që mund ta kishim shfrytëzuar për dëshminë.

Sidoqoftë, ne duam të jemi të drejtë. Duam t'ju japim të gjithëve mundësi të mjaftueshme për t'u përgatitur, por mos e bëni këtë zakon. Fakti që do ta lejojmë sot, nuk do të thotë që do ta lejojmë një herë tjetër.

Atëherë sot miratojmë kërkesën tuaj. Nuk keni nevojë të shtoni gjë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Do kërkoja ndjesë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'keni nevojë të kërkoni ndjesë. E miratojmë kërkesën tuaj për të qenë të drejtë me të gjitha palët e përfshira, dhe shpresojmë që me këtë dëshmitar të përfundojmë në mënyrë efikase.

Në qoftë se Prokuroria vendos se do të dojë të përdorë videolidhjen për pjesën e fundit të pyetjeve ne nuk do ta kundërshtojmë. Dhe nëse do të kundërshtohet nga ndonjë prej jush, unë po ua them që tani që do t'ua rrëzojmë kundërshtimin.

Megjithatë, e vendos Prokuroria çfarë do të bëjë nëse dëshmitari do të fizikisht apo do të ndiqet përmes videolidhjes. Edhe një herë po ua them, kjo s’do bëhet praktikë se kemi dhe një shkëputje dyjavore që e bën edhe më të vështirë tani.

Mirë pra, miratojmë kërkesën e z. Emmerson. Nuk do të vazhdojmë më për sot dhe do të fillojmë pas dy javës.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë kam disa prova materiale që duhet t'i japim për procesverbal.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni me shkrim siç do ta bëjë edhe Prokurori edhe le ta shmangim edhe këtë, ju lutem. Kur keni për të dorëzuar ndonjë dokument për provat gjyqësore bëjeni në momentin e duhur, mos na i jepni dy ditë më pas.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, kam idenë që z. Halling tha që unë dua të përdor materialet që përdori Gjykatësi Mettraux si prova materiale për me. A e kam kuptuar unë siç duhet?

Z. HALLING: [Përkthim] Mund t’jua sqaroj unë. Ne do të kërkojmë që të pranohen si prova gjyqësore dhe kjo nuk është ndryshe nga situata me Dëshmitarin 04769. Por sikurse ju thashë, ne për këtë do të bëjmë parashtrim me shkrim për cilat prova materiale e kemi fjalën.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Shpresoj që kjo e sqaroi edhe në çfarë pozita ndodhem unë, pra, që Prokurori po zgjedh tani t'i përdorë, madje edhe si prova materiale, materialet që përdorën

Gjykatësit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur do ta çoni këtë material?

Z. HALLING: [Përkthim] Do ta bëjmë këtë në afatin që na jepni ju.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bëni deri të premten.

Z. HALLING: [Përkthim] Nesër?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nesër, jo. Atëherë mund ta bëni deri të hënën.

Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë më datën 22 prill.

--- Seanca mbyllet në orën 15.50